Kronikë

Durrës/ Vriten me armë zjarri dy të rinj pranë një karburanti në Manëz, shpallet në kërkim një 21-vjeçar! Kamarieri: Konflikti nisi për një kafe (EMRAT+VIDEO)

Sherri nisi fillimisht për një kafe në lokal. 21-vjeçari Daniel Pepa debaton me kamarierin për kafen. Ndërhyn 33-vjeçari Flori Paluçi, ky nxjerr armën dhe vret Aranit Kurtin që shoqëronte Pepën. Më pas ky i fundit, shkon e merr armën në makinë dhe vret Paluçin. 7 të shoqëruar në polici.

E shkuara kriminale e Flori Paluçit, i arrestuar për grabitje masive me dhunë në Itali

Dështmia e kamerierit: Danieli më kërkoi kafe, por kisha fikur ekspresin! Më ofendoi

Punonjësi: Kur erdha në mëngjes, pashë karburantin e rrethuar si skenë krimi! Banori: Kurtin e kisha kushëri

Lajmi i fundit

Po perëndon dielli i Macron si vizionari kryesor i Evropës

22 Tetor, 20:36

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
22 Tetor, 07:23 | **Përditesimi: 22 Tetor, 16:11**

Share

DURRËS – Një debat me kamarierin për një kafe në një lokal ka përfunduar me dy të vrarë në Manëz. Ngjarja e rëndë u shënua pranë një karburanti rreth orës 01:45, ku 33-vjeçari Flori Paluçi ka vrarë me armë zjarri 23-vjeçarin Aranit Kurti. Më pas ndaj 33-vjeçarit ka qëlluar një 21-vjeçari Daniel Pepa, duke e lënë të vdekur. 21-vjeçari është shpallur në kërkim, ndërsa grupi hetimor ndodhet në vendngjarje.

Në polici janë shoqëruar 7 persona, të cilët mund të kenë dijeni për ngjarjen. Sipas të dhënave nga grupi hetimor, Daniel Pepa së bashku me Aranit Kurtin kanë shkuar në lokal dhe Danieli i ka kërkuar kamarierit të lokalit që t'i bënte një kafe. Kamarieri i është përgjigjur që ekspresi ishte i fikur dhe se nuk mund të bënte kafe.

Më pas, sipas informacioneve, Danieli i ka kërkuar që ta ndizte ekspresin duke përdorur edhe fjalë fyese në drejtim të kamarierit. Aty ka ndërhyrë Flori Paluçi, i cili i ka thënë se nuk mund ta fyejë kamarierin, pasi është ulur në tavolinë me të. Pas këtij momenti kanë nisur debatet verbale mes tyre dhe kanë degjeneruar deri në përdorimin e armës së zjarrit. Sipas dinamikës paraprake, i pari që ka qëlluar është Flori Paluçi, i cili ka vrarë Aranit Kurtin, dhe më pas Daniel Pepa ka qëlluar duke lënë të vrarë Paluçin.



LEXO EDHE:
Kreshnik Spahiu: Pse 'shqiptarët' vriten për një filxhan ekspres?

Të rinjtë janë ngritur nga tavolina, kanë dalë jashtë lokalit dhe aty situata ka agravuar. Sipas dinamikës paraprake të ndërtuar nga grupi hetimor, i pari ka qëlluar me armë Flori Paluçi, i cili ka hapur zjarr ndaj Aranit Kurtit, duke e lënë të vdekur në vend. Në ato momente, Daniel Pepa ka marrë një armë zjarri, pistolete, të cilën ende nuk dihet nëse e kishte në brez apo në makinë, dhe ka qëlluar drejt Paluçit, duke e lënë të vdekur në vend. Të dy vrasjet kanë ndodhur jashtë lokalit.

Pas krimit, Daniel Pepa është larguar nga vendngjarja edhe pse stacioni i policisë së Manzës, ndodhet përballë karburantit, në një distancë 30 metra.

> *"Rreth orës 01:45 të datës 22.10.2025, në Manëz, pranë një karburanti, pas një konflikti dyshohet për motive të dobta, kanë mbetur të vrarë me armë zjarri shtetasit A. K., 23 vjeç, dhe F. P., 33 vjeç, të dy banues në Manëz.*
>
> *Nga veprimet e para hetimore të kryera nga grupi i posaçëm hetimor, dyshohet se shtetasi F. P. është vrarë me armë zjarri nga shtetasi D. P., 21 vjeç, banues në Manëz, ndërsa shtetasi A. K. dyshohet se është vrarë nga shtetasi F. P. Shërbimet e Policisë po vijojnë kontrollet intensive për kapjen e shtetasit D. P.*
>
> *Ndërkohë, një grup i posaçëm hetimor, nën drejtimin e Prokurorit, po vijon punën në vendngjarje për zbardhjen e rrethanave, identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje dhe administrimin e çdo prove, me qëllim dokumentimin e plotë ligjor të rastit.", njofton policia.*

Kur policia mbërriti në vendngjarje gjeti vetëm kamerierin, i cili u shoqërua dhe u mor në pyetje në komisariat. Gjithashtu u sekuestruan kamerat e sigurisë së lokalit dhe karburantit dhe u mblodhën gëzhojat. Në vendngjarje u sekuestrua dhe pistoleta e përdorur në krim nga Paluçi.

Në dështminë e tij, kamerieri Alteo Pepa ka treguar për hetuesit se Daniel Pepa me të cilin nuk ka lidhje farefisnie i kërkoi nje kafe. Ai shoqërohej nga shoku i tij, Aranit Kurti. *"I thashë që s'ka kafe sepse ekspresi është fikur që në orën 00:00. Ai u acarua dhe nisi të më ofendonte. Në atë moment ndërhyri Flori, që më doli mua në krah. Debatuan me Danielin dhe dolën jashtë për tu sqaruar…".*

Përpos kamerierit policia ka pyetur dhe persona të tjerë, në cilësinë e dështmitarëve të cilët s'kanë dhënë shumë detaje.

Ndërsa kushëriri i viktimës thotë se e ka të vështirë të besojë se 23-vjecari u vra për një kafe.

> *"Na ka lënë pa fjalë kjo që ndodhi. Aranitin e kisha kushëri, ishte djalë i qetë", tha ai.*

Sakaq, burimet policore bëjnë me dije se Flori Paluçi nga Hamallaj, ishte me precedent penal, i arrestuar më herët për tentativë vrasjeje dhe grabitje ne Itali. Po kështu autori i dyshuar Daniel Pepa, i shpallur në kërkim është person problematik në Manëz, i dyshuar për plagosje të mëparshme. Policia po vijon kërkimet për kapjen e tij, ndërkohë prokoruria pritet te thelloje hetimet. Nuk përjashtohet pista e konflikte të vjetra, pasi 4 të rinjtë banonin në të njëjtën zonë dhe dy prej tyre ishin të armatosur.

Një prej viktimave Aranit Kurti

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:24

Qëlloi për vdekje 23-vjeçarin në Durrës, e shkuara kriminale e Flori Paluçit, i arrestuar për grabitje masive me dhunë në Itali

Autori i njërit prej vrasjeve të regjistruara mëngjesin e sotëm në Manëz të Durrësit, Flori Paluçi 33 vjeç, është i njohur për të shkuarën e tij kriminale.

Ai ka qenë arrestuar më parë në vitin 2015 në Itali, pjesë e një bande grabitësish. Grupi përbëhej nga 6 sicilianë dhe 1 shqiptar, Flori Paluçi, të cilët si metodë identifikuese të punës së tyre, kishin hapjen e një vrime në muret e biznesëve që piketonin për të grabitur.

Autoritetet italiane nisën hetimet në verën e vitit 2014 kur në 20 ditë, 30 qershor dhe 21 korrik), dyqanet e bizhuterive Barbieri në Ravenna dhe Montanari-Felloni në Alfonsine u sulmuan në bastisje shumë të ngjashme të dhunshme.

Në një rast, grabitësit janë gjetur brenda një argjendarie nga pronari, shumica prej të cilëve në duar mbanin armë lodër. Ata arritën të largoheshin ndërsa me vete morën 6 kilogramë sende me verë 200,000 euro.

"*Mund të themi me siguri se kemi të bëjmë me individë jashtëzakonisht të rrezikshëm*", komentoi Kryeprokurori Alessandro Mancini, duke shpjeguar operacionin gjatë një konference për shtyp. "*Shumë prej tyre kanë të dhëna specifike për recidivizëm dhe dhuna e veprimeve të tyre do të kërkojë ndjekje penale shumë të rëndë. Qëllimi i vetëm i këtyre të ashtuquajturve grabitës ishte të planifikonin grabitjet e tyre, duke kryer inspektime të hollësishme të vendit për të identifikuar objektiva të mundshëm dhe duke përjashtuar vende të tjera*", raportonte në atë kohë ***media italiane.***

K.B/Shqiptarja.com

Share

Ora 10:15

U vra pas sherrit për një kafe në Manzë, Report Tv siguron foton e të riut Aranit Kurti



Viktima Aranit Kurti

Report Tv ka siguruar foton e të riut Aranit Kurti, i cili mbeti i vrarë në konfliktin për një kafe në Manzë të Durrësit. 23-vjeçari ka qenë i ulur në tavolinë me Daniel Pepën, 21 vjeç, i cili i ka kërkuar kafe kamerierit, por ai nuk ia ka bërë për shkak se ekspresi ka qenë i fikur. Pas sherrit, personi që ishte në tavolinë me kamerierin, Flori Paluçin ka marrë armën dhe ka qëlluar në drejtim të Aranit Kurtit duke e lënë të vdekur.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:58

Vrasja e dy të rinjve në Manëz, Dëshmia e kamerierit: Danieli më kërkoi kafe, por kisha fikur ekspresin! Më ofendoi

7 persona janë shoqëruar pas vrasjes së dy të rinjve në Maznë të Durrësit, pas një konflikti një nisi për një kafe. Report Tv ka ardhur dëshminë e kamerierit, Alteo Pepa, i cili para grupit hetimor ka treguar dinamikën se si ka ndodhur ngjarja.

21-vjeçari Daniel Pepa, i cili rezulton tashmë i shpallur në kërkim, ka shkuar në lokalin ku punonte kamerieri dhe ka kërkuar kafe. Por, kamerieri ka dëshmuar se i ka thënë që ekspresi është fikur dhe i duhen disa minuta që të ngrohet në mënyrë që t'i shërbente kafe.

Por, 21-vjeçari nuk është larguar dhe ka vijuar të qëndrojë në tavolinë bashkë me Aranit Kurtin, duke e ofenduar dhe duke i kërkuar vazhdimisht që t'i bënte kafen. Kamerieri ishte i ulur me 33-vjeçarin Flori Paluçi dhe në momentin që 21-vjeçari ka vijuar të ofendojë, Flori Paluçi ka ndërhyrë dhe i ka thënë që s'mudn të sillet ashtu me kamerierin. Grupet kanë vijuar debatin verbal, deri kur 33-vjeçari Paluçi ka nxjerrë armën dhe ka qëlluar në drejtim të Aranit Kurtit, i cili ka mbetur i vdekur. Më pas, Daniel Pepa ka shkuar në makinë, ka marrë armën dhe ka qëlluar në drejtim të 33-vjeçarit, i cili po ashtu vdiq për shkak të plagëve.

> *"Daniel Pepa erdhi në lokal dhe më kërkoi një kafe. Bashkë me Daniel Pepën ishte edhe një shok i tij. I thashë që nuk ta bëj dot kafenë se ekspresi kërkon kohë të ngrohet. Ekspresin e kisha fikur që në orën 00:00, më tej nuk shërbejmë. Kur i thashë se nuk ta bëj dot kafenë, Danieli më ofendoi. Ai ngulmoi t'ia bëja kafenë. Nuk i ktheva përgjigje, por ndërhyri Flori Paluçi. Flori Paluçi i tha Daniel Pepës që të mos më fyente. Paluçi dhe Pepa debatuan me njëri-tjetrin, më pas dolën te dera.", tha Alteo Pepa, 21 vjeç.*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:33

Vrasja e dy të rinjve në Manëz, punonjësi: Kur erdha në mëngjes, pashë karburantin e rrethuar si skenë krimi! Banori: Jemi të tronditur, Kurtin e kisha kushëri

Punonjësi i karburantit pranë të cilit u vranë dy të rinjtë Flori Paluçi dhe Aranit Kurti ka folur për mediat lidhur me ngjarjen e rëndë. Ai tha se kur shkoi në punë në mëngjes pa karburantin e rrethuar si skenë krimi, ndërsa djemtë i përshkruan si të sjellshëm.

> *"Unë erdha në mëngjes, gjeta karburantin e rrethuar, si skenë krimi. Më thanë ka ndodhur në ngjarje. Njëri nga Manza por nuk rri këtu. Ishin çuna të sjellshëm.", u shpreh punonjësi i karburantit.*

Ndërsa një banor thotë se janë tronditur nga ngjarja e rëndë. Banori thotë se Aranit Kurtin që mbeti viktimë e ka pasur kushëri.

> *"Jo nuk dimë gjë. Na ka tronditur rëndë por ndodhi. Nuk di gjë pse ka ndodhur. I njihja, e kam pasur kushëri Aranit Kurtin", thotë një tjetër banor.*

Xh.D/Shqiptarja.com

Share

Xh.D/I.M/Shqiptarja.com

TAG: manëz | policia e durresit | Durres | vrasje me armë zjarri | Flori Paluçi | Aranit Kurti | Daniel Pepa | vrasje | alteo pepa

Komento

Komente

Brezi i ri: 22/10/2025 18:54

Brezi i ri duhet te krijoj miqesi dhe jo lufte apo ngjarje te tilla shume shume gabim! Krijimi miqve behet me diplomaci , nuk do kete Shqipëri nese ska shqiptar shume gabim keto edukata qe krijon perplasje mes te rinjve ! Duhet komunikim , miqesi , dhe diplomaci. Cfare merret ne jete me fjale me shoqeri me miqesi me diplomaci kurre nuk merret me force ! Pordorni miqesine mos u zini per gjera kot 28.748km2 ka vend per gjithe shqiptaret mos beni keshtu ngjarje more brez i ri! Ngushéllime familjeve

Përgjigju

Cekja: 22/10/2025 14:49

Ti shkojne per kafe njeri tjetrit tani dhe kursejne ate 100 lekesh me kete rast!

Përgjigju

Medet: 22/10/2025 13:12

Dy jete = nje kafe, dmth 40 leke vlen jeta e njeriut ne Shqiperi.

Përgjigju

Kafja e vjeter: 22/10/2025 18:56

Kafja me e lire sot kushton 70 Lek (0.70 € apo 70cent)! Brezi i ri ka marre pamje dhune Jane brezi I krijuar gjate 12-16-te vite qeverisje te se njejtes parti grup politik

Salire: 22/10/2025 15:44

80 leke:2 veta= 40 leke per koke.

popull: 22/10/2025 15:05

o vlla ku ka kafe 40 lek ne shqiperi me?

Ded pill karmarkaj: 22/10/2025 11:24

Muhabete malokesh gjell qensh, marrin si pushka evgjitit dhe ikin ne te arushes, shqiperia duhet te ndahet, veriu shqiperis duhet te izolohet dhe malokeve tu behet vaksina kunder terbimit

Përgjigju

viqidoli: 22/10/2025 11:42

Dakort

Ton: 22/10/2025 11:22

Si perfundim a u ndez ekspresi?

Përgjigju

endri: 22/10/2025 10:59

i mesoi demokracia me arme se ne kohen e xhaxhit as nuk e shihnin as ne foto.

Përgjigju

duren: 22/10/2025 10:56

si ka mundesi qe qarkullojn me arme te rinj ku naten duhet te kete me shume kontrolle te rinj te pa formuarr mosha 21 nuk duhet as kafen me perdor e jo te jete domosdoshmeri kafja o zot ca brezi po rritet policia e korruptuar komplet.

Përgjigju

Prit prit se erdha: 22/10/2025 10:55

Shqiperi te befsha naften

Përgjigju

Gjin Gjon Gjoka: 22/10/2025 10:38

He bre burra ju lumshin duart..

Përgjigju

Alb: 22/10/2025 10:29

Brezi i demokracis injoranta si politika edhe populli

Përgjigju

Trump: 22/10/2025 10:11

Jeta e nates ne Shqiperi. Te gjithe qarkullojne te armatosur. Policia fle gjume.

Përgjigju

Hama Timua: 22/10/2025 09:38

O zot çfar kafshēsh vriten pēr njē fjal goje , tamam kafsh me fytyr njeriu. E gjith kta tē vdekur kto 35 vjet kan vetėm Firmen e njeriut mē tė zi nē gjith historin e Shqipris Sali Kryekriminel Hajdut Bajga. Zoti mart hak te ky monstēr njeri.

Përgjigju

Alex: 22/10/2025 09:29

Dy me pak.....!!!!!!!! Po te ishin me shume do ishte me mire per ne te tjeret .

Përgjigju

Eri: 22/10/2025 09:26

E kur deshta me ardh une me pushime ne nentor ne shqiperi !!!! No way man

Përgjigju

O eri: 22/10/2025 14:25

Shyqyr qe fliske shqip e vlla, ca te duhet shqiperia ty. Ik andej ne midwest.

Faji gjykatsave: 22/10/2025 08:28

Te gjith qarkullojn me arme lirshem sepse gjykatat si denojn . Po te benin burg sa e parashikon ligji per armembajtjen as ne foto nuk do i shikonin armet. Jo me te dalin lirshem neper qytete

Përgjigju

Kombi: 22/10/2025 08:49

Shume e drejte.

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës: 22 Tetor, 09:21

A duhet që SPAK të hetojë kryengritjen e armatosur të 14 shtatorit 1998?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

AMP pezullon nga detyra 4 efektivë të Policisë së Kavajës, nuk parandaluan kultivimin e kanabisit në zonat që mbulojnë

22 Tetor, 14:25

Vrasja e dy të rinjve në Manëz, punonjësi: Kur erdha në mëngjes, pashë karburantin e rrethuar si skenë krimi! Banori: Jemi të tronditur, Kurtin e kisha kushëri

22 Tetor, 09:33

125 vjetori i vdekjes së Rilindasit! Ndriçim Xhepa dhe Yllka Mujo recitojnë vargjet e Naim Frashërit në Kullën Veneciane

Aldo Mustafa

21 Tetor, 17:17

Shfrytëzoi për 3 vite për prostitucion 30-vjeçaren, arrestohet 42-vjeçari në Durrës (VIDEO)

21 Tetor, 13:30

Projekti/ Fushë e re futbolli me standardet e UEFA-s në Katund të Ri, Bashkia e Durrësit hap prokurimin me vlerë 666 mijë euro

21 Tetor, 11:16

Shpërndante kanabis në doza, arrestohet 19-vjeçari në Durrës (VIDEO)

21 Tetor, 09:58

Studentët turq në 'Universitetin Aleksandër Moisiu' në Durrës për studime: Diploma njihet ndërkombëtarisht

Artur Korriku

19 Tetor, 17:54

VIDEOLAJM/ Plazh në tetor, turistët e huaj vijojnë të shijojnë detin në Durrës

19 Tetor, 14:46

Aksident në aksin 'Maminas-Gjiri i Lalëzit'/ Përplasen tre automjete, plagosen dy vajza (VIDEO)

19 Tetor, 13:42

Itali/ Vrasja me thikë e 23-vjeçarit shqiptar në parkingun e Universitetit të Perugias, shpallet në kërkim një i ri tunizian! Dinamika e ngjarjes

19 Tetor, 13:36

Po transportonin 10 kg hashash për shitje, arrestohen 2 persona në Fushë-Krujë! Sekuestrohet dhe armë zjarri pa leje (EMRAT)

19 Tetor, 11:17

Itali/ 23-vjeçari shqiptar vritet me thikë në parkingun e Universitetit të Perugias! Autor dyshohet një i ri, më herët u konfliktuan në një klub nate

18 Tetor, 13:41

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje